



Data 21.02.2020

FTESE PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIME TË UDHËTIMIT PËR REALIZIMIN E STUDIMIT MBI AKSESIN E SME-VE NË FINANCA NË QARKUN FIER

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), në kuadër të projektit ‘3C4SME Work Plan of the Context Analysis’, për realizimin e një studimi në Bashkinë Fier, **hap thirrjen për shërbime të udhëtimit për realizimin e studimit mbi aksesin e SME-ve në financa në qarkun Fier** si më poshtë.

Informacion i përgjithshëm rreth QSHPZH

QSHPZH-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues dhe zhvillimin.

Organizata duke qënë implemetuese e projektit: “3C4SME Work Plan of the Context Analysis”, i cili zbatohet nga Qendra Shqiptare per Popullsinë dhe Zhvillimin ne Bashkine Fier, hap thirrjen për shërbime transporti:

- Ftojme kompani/persona fizik të licencuar per sigurimin e shërbimeve të udhëtimit për realizimin e studimit mbi aksesin e SME-ve në financa, në zonat e projektit 3C4SME në qarkut Fier, me qëllim realizimin e objektivave të Projektit.

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KONTRAKTIMIT

Synimi i përgjithshëm i kontraktimit është sigurimi i shërbimeve të udhëtimit për realizimin e eventeve/aktiviteteve të studimit mbi aksesin e SME-ve në financa në qarkun Fier, me qëllim përmirësimin e aksesit në financa të SME-ve, në kuadër të projektit “**3C4SME Work Plan of the Context Analysis**”, për realizimin e nje studimi me bizneset e vogla dhe të mesme, kryesisht bujqësore dhe tregtare, për vlerësimin e nevojave të tyre për kredi në Bashkinë Fier.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

2. Sherbimet kontraktuale

QSHPHZH kerkon te realizoje sherbimin kontraktual:

- Shërbime të udhëtimit për realizimin e eventeve/aktiviteteve në kuadër të studimit mbi aksesin e SME-ve në financa në qarkun Fier, me qëllim përmirësimin e aksesit në financa të SME-ve, në kuadër të projektit “3C4SME Work Plan of the Context Analysis”

Permbajtja e shërbimit:

1. Udhëtime Tiranë-Fier dhe kthim në baza pothuajse ditore kryesisht gjatë periudhës qershor-tetor 2020. Totali: jo më pak se 60 udhetime Tiranë-Fier dhe kthim
2. Brenda qarkut Fier, udhëtime ne zona të ndryshme të SME-ve tregtare, industriale, bujqësore, turistike, etj. Totali: jo më pak se 130 udhëtime brenda qarkut Fier.

QSHPHZH kerkon:

- Kompani/Persona Fizik të interesuara per sigurimin e shërbimeve si më sipër shpjeguar.

Fondi limit është **984,000** lekë.

3. Data dhe vendi

Me kërkesë të organizatës, produktet dhe shërbimet do të dorëzohen në Qendren *Shqiptare per Popullsinë dhe Zhvillimin* , adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania.

4. Profili i kërkuar i kompanisë/OJF aplikuese

- Park mjetesh motorrike ne gjendje te mirë mikrobuze ose autovetura, që mund të aksesojnë në zona rurale .
- Eksperience të gjere në shërbime transporti brenda dhe jashtë vendit.
- Kontakte, njohuri dhe informacion të gjerë rreth vend-ndodhjeve ne shkallë vendi dhe për qarkun Fier në veçanti.
- Experiencë e vërtetuar pune në fushën e transportit .

5. Kontratat dhe Tarifat

Kompanitë/ persona fizik do të lidhin një kontratë shërbimi me organizatën. Pagesa do të kryhet në llogarinë bankare të kompanisë/ personit fizik sipas kushteve të rëna dakort në kontratë dhe dorëzimit të produkteve/ shërbimeve përkatëse.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Aplikimi

Ju ftojme të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja brenda datës **06.03.2020, ora 16:30** me E-mail (info@acpd.org.al) me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania, tel:

Çdo aplikim i marrë pas datës së mbylljes së procedures nuk do të pranohet.

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT , Licence, Ekstrakt QKB
- Oferta Financiare për shërbimin që kërkohet .

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit, eksperiences dhe oferten me te ulet financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.